



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Janar 2021

Data 26.01.2021 ora 14.00

Vendi: Mbledhja zhvillohet online sipas aplikacionit Meet, mbështetur në Aktit Normativ nr.3 datë 15.03.2020, neni 5.

Rendi i ditës

1. Projekt Vendim për "Miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2021"
2. Projekt Vendim " mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Dhjetorë 2020"
3. Projekt Vendim "Për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari dhe e pyjeve që kulloten"
4. Projekt vendim "për miratimin e listës së ngastrave/nëngastrave të gatshme për dhënie në përdorim"
5. Projekt vendim për rinvim kontrate të dhënies në përdorim me qera të fondit pyjor / kullosor për shfrytëzim kromi Shoqëria "Sokolaj" shpk
6. Projekt vendim per miratim në ngastren nr.41 c të sipërfaqes prej 300 m² në ekonominë pyjore Shllak 1, për ndërtime të përkohshme "Për qender stani e rrëthuar, ngrehinë banimi për barinjtë dhe stafin"
7. Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat 9 vjeçar të siperfaqes pyjore prej 0.747 ha në ngastren nr.14 në ekonomine pyjore Drin Gjader Kir për qëllime pushimi, argetimi, shëndetësore, shoqërore dhe për veprimtari turistike, campingje (kënde lojërash, mjedise sportive, shlodhëse etj.).
8. Projekt vendim për miratimin e listës së përfituesve , aplikues në programin "Përmirësimi i kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese deri në një ndertim të ri"
9. Të ndryshme.



Mbledhja e rradhes e Këshillit Bashkiak Vau Dejes për muajin Janar 2021,u zhvillua me datë 26.01.2021 ora 14.00 online sipas aplikacionit Meet.Të pranishem online ishin 21 këshilltarë,korum i mjaftueshmë për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.Fjalen për hapjen e mbledhjes e mori Ervis Shimaj, zv/kryetari i këshillit bashkiak, sipas autorizimit nr.6070 prot.datë 15.10.2020 lëshuar nga Kryetari Këshillit Bashkiak Z.Mark Bisha.

Z.Ervis Shimaj lexoi rendin e ditës dhe u pyeten këshilltarët nëse ishin dakort për rendin e ditës.Znj.Sanje Salja mori fjalen dhe u shpreh se kishte një propozim që pika e 5 (pestë) e rendit të ditës të mos shqyrtohet në këtë mbledhje sepse sipas materialit që jemi pajisur nuk jam e qartë nëse për këtë projekt vendim që paraqitet për **shqyrtim per rinovim kontrate të dhënies në përdorim me qera të fondit pyjor / kullosor për shfrytëzim kromi Shoqëria "Sokolaj" shpk**, a është bërë dëgjesë publike në kohen e paraqitjes së projekt vendimit per tu dhene ne përdorim.Prandaj u shpreh znj.Sanje kerkoj qe ky projekt vendim te mos kalohet ne kete mbledhje deri ne momentin qe te kemi një spjegim ligjor te sakte nga zyra e pyjeve prane Bashkise Vau Dejes.Propozimi i Znj Sanije u hodh ne votim dhe u u miratua me shumicene e votave te këshilltarëve online.

Mbledhja fillon me rendin e dites pa perfshire piken 5 (pesë) per rinovim kontrate të dhënies në përdorim me qera të fondit pyjor / kullosor për shfrytëzim kromi Shoqëria "Sokolaj" shpk.

Lexohet pika e parë e rendit të dites nga z.Ervis Shimaj: Projekt Vendim për "Miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike për vitin 2021"

U kërkua nga z.Frano Prenga që te mos behet referim i projekt vendimeve nga perfaqesuesit e zyrave meqenese jemi njohur me materialet dhe meqe jemi online.

Fjalen e merr znj.Franga Kola si kryetare e komisionit te çeshtjeve sociale dhe barazise gjinore e cila referon se projekt vendimi eshte shqyrtuar nga komisioni dhe se eshte shprehur dakortesi per miratim.Këshilltarët nuk kishin diçka per te shtuar,hidhet ne votim:**Miratohet me 21 vota PRO.**

Lexohet pika e dytë e rendit të dites nga z.Ervis Shimaj: Projekt Vendim " mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fundi i kushtëzuar për muajin Dhjetorë 2020"

Edhe per kete pike referon znj Franga Kola e cila shprehu dakortesine e komisionit per miratim.

Këshilltarët nuk kishin diçka per te shtuar,hidhet ne votim:**Miratohet me 21 vota PRO.**

Lexohet pika e tretë e rendit të dites nga z.Ervis Shimaj: Projekt Vendim "Për miratimin e listës së kullotave të gatshme për kullotje dhe kositje bari dhe e pyjeve që kulloten"

Referon z.Rrok Ftoni – drejtor i zyres se pyjeve,i cili u shpreh se nga zyra e pyjeve eshte bere listimi i kullotave te gatshme per kullotje dhe kositje bari me qellim qe ne rtastet e kerkesave per marrje me qera

NAKËSHËNJE

apo perdorim ti kemi te gatshme per te pregaditur materialet e nevojshme qe kerkohen per hartimin e projekt vendimeve dhe te kemi te qarte se cilat ngastra do te jepen me qera apo perdorim.

Këshilltarët nuk kishin diçka per te shtuar,hidhet ne votim:**Miratohet me 21 vota PRO.**

Lexohet pika e katërt e rendit të dites nga z.Ervis Shimaj: **Projekt vendim “për miratimin e listës së ngastrave/nëngastrave të gatshme për dhënien në përdorim”**

Relaton z.Rrok Ftoni – drejtor i zyres pyjeve prane Bashkise Vau Dejes i cili spjegon se eshte bere lista e ngastrave dhe nenngastrave per dhenie ne perdorim,ku nepermjet tyre saktesojme pronat qe jane ne administrim te Bashkise dhe mund te jepen ne perdorim sipas kerkesave qe mund te behen nga te interesuarit.

Z.Jak Cara - këshilltar,thotë se degjesat publike duhet te behen per çdo rast qe kerkohet dhenie ne perdorim te pronave te Bashkise.

Z.Rrok Ftoni sqaron se per çdo rast qe kerkohet marje prone me qera apo perdorim,jane bere me degjesa publike.

Pyeten këshilltarët nëse kanë diçka për të diskutuar.Nuk kishin per te diskutuar këshilltarët.Hidhet ne votim:Vota PRO 20,Vota kundra asnje,**Vota abstenim 1 (një).**Z.Jak Cara abstenon.

Miratohet me 20 vota PRO.

Lexohet pika e pestë e rendit të dites nga z.Ervis Shimaj: **Projekt vendim per miratim në ngastren nr.41 c të sipërfaqes prej 300 m² në ekonominë pyjore Shllak 1, për ndërtime të përkohshme “Për qender stani e rrethuar,ngrehinë banimi për barinjtë dhe stafin”**

Z.Ervis Shimaj sqaron këshilltarët se per kete projekt vendim eshte bere njoftimi per degjese publike online,i cili eshte shpallur ne kendin e transparencës se Nj.A Shllak dhe ne web-in e Bashkise Vau Dejës,ku janë ftuar te gjithe banorët dhe grupet e interesit qe te shprehnin sugjerimet e tyre ne adresat elektronike te vëna në dispozicion.Mirepo ne adresat elektronike nuk kemi patur asnje sugjerim lidhur me projekt vendimin e mesiperm.

Z.Rrok Ftoni – drejtor i zyres se pyjeve relaton projekt vendimin dhe sqaron këshilltarët lidhur me tipin dhe proceduren e kerkeses se paraqitur.

Pyeten këshilltarët nëse kanë diçka për të diskutuar.Nuk kishin per te diskutuar këshilltarët.Hidhet ne votim: **Miratohet me 21 vota PRO.**

Lexohet pika e gjashtë e rendit të dites nga z.Ervis Shimaj: **Projekt vendim për dhënien në përdorim me afat 9 vjeçar të sipërfaqes pyjore prej 0.747 ha në ngastren nr.14 në ekonomine pyjore Drin Gjader Kir për qëllime pushimi,argetimi,shëndetësore,shoqërore dhe për veprimitari turistik,kampingje (kënde lojërash, mjedise sportive, shlodhëse etj).**

Z.Ervis Shimaj spjegon që edhe per kete projekt vendim eshte bere degjese publike dhe se te gjithe te pranishmit ne degjese jane shprehur pro ketij projekt vendimi.

Z.Rrok Ftoni relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur dhe spjegon se eshte ndjekur e gjithe procedura ligjore per hartimin e ketij projekt vendimi dhe se zbatimi i ketij projekt vendimi sjell te ardhura per Bashkine si dhe zhvillim per zonen ku tdo te zbatohet ky projekt vendim.

Pyeten këshilltarët nëse kanë diçka për të diskutuar.Nuk kishin per te diskutuar këshilltarët.Hidhet ne votim: **Miratohet me 21 vota PRO.**

Lexohet pika e shtatë e rendit të dites nga z.Ervis Shimaj:**Projekt vendim për miratimin e listës së përfituesve , aplikues në programin “Përmirësimi i kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese deri në një ndertim të ri”**

Znj.Çuka Babani – perjegjese e sektorit të shërbimit social prane Bashkise Vau Dejes – relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur,e cila shprehet se te gjitha kerkesat e paraqitura per te perfituar nga programi i mesiperm,jane shqyrtuar nga komisioni i çeshtjeve sociale dhe barazise gjinore prane Këshillit Bashkiak Vau Dejes dhe se jane ndjekur te gjitha procedurat ligjore.

Znj.Franga Kola – kryetare e komisionit te çeshtjeve sociale dhe barazise gjinore prane Këshillit Bashkiak Vau Dejes,relatoi se ne si komision i kemi bere verifikimet e listes se perfituesve sipas projekt vendimit te paraqitur prej 14 personave,ku kemi kontrolluar dokumentacionin e paraqitur dhe kane rezultuar se perfituesit ishin kualifikuar sipas kritereve te miratuara me parë.Kërkuesit e skualifikuar kishin mungesë të dokumentacionit.Lind detyre e zyres se çeshtjeve sociale qe te bejne te mundur sqarimin e kerkuesve se çfarë dokumentash duhen per te perfituar nga ky program dhe tu jepet ndihma e nevojshme per kete qellim,pra plotesimin e dokumentacionit qe kerkohet.

Znj.Sanie Salja – anëtare e K.B pyet:1.Çfarë shume perfitorje keto perfitues? Dhe pyetja e dyte:
2.Pse nga NJ.Administrative Bushat nuk ka asnje perfitues,e cila permend disa persona qe kane bere kerkese dhe nuk jane ne listen e perfituesve?

Znj.Çuka Babani perpjigjet:Jane te ftuar te marrin pjese ne aplikim te gjithe banoret qe mendojne se i plotesojne kriteret.Per te prftuar duhet te plotesohen kriteret ligjore te miratuara dhe se nuk mund te kalohen per miratim kerkuesit qe kane mungese ne dokumentacion sepse ne nuk mund te shkelim ligjin.Lidhur me financimin eshte i perbashket Qeveri-Bashki.Nga ana e qeverise kerkohet minimumi 20% e investimit nga ana e Bashkise.Ne po ju hapim rrugen ligjore qytetarëve qe te behen perfitues.Pyeten këshilltarët nëse kanë diçka për të diskutuar.Nuk kishin per te diskutuar këshilltarët.Hidhet ne votim:Votojne PRO 20 këshilltarë,1 (një) votë abstenim (Sanje Salja),Kundra nuk ka.

Miratohet me 20 vota PRO.

Z.Ervis Shimaj kalon ne piken tetë të rendit të ditës:Të ndryshme.

Znj.Davida Huba – anëtare e këshillit: Kërkoj që të bëhet rrethimi i shkolles së Naraçit, meqenese shkolla eshte ristrukturuar dhe se eshte i nevojshem edhe rrethimi i ambjenteve te sajë.

Znj Franga Kola – anëtare e këshillit: Kam një problem per invalidet e Bashkise, te cilet kane nevoje te pajisen çdo vit me libreze invaliditeti, te cilet sorollate per një sherbi te tille sepse ky sherbi u realizoka nga një person me emrin Nora Rrotani dhe se invalidet nuk dijnë se ku mund ta gjejne kete person.

Z.Jak Cara - anëtarë i këshillit: 1.Në Vau Dejes kemi një nenstacion te degraduar i cili ka shume defekte.

2.Të mendohet per ndonje parking ne qytetin e Vau Dejes.

3.Kemi një kontratë me ujesjellesin per tu pajisur me ujë.Ujesjellesi i ri nuk ka bere lidhjet me kontraktoret(banorët) , i kane lene larg shtepijave keto lidhje, si do te zgjidhet?

Znj.Valbona Llukaj – anëtare e këshillit:Në Mjedë nuk eshte bere asnje investim pamvaresisht se eshte e perfshire ne projektin e 100 fshatrave qe do investohet nga qeveria.Kerkoj:

Ne kanalin qe kalon permes fshatit Mjede,i cili ka shumë mbeturina, te pastrohet nga ana e Bashkisë.

Znj.Majlinda Ndreca – anëtare e këshillit:Kerkoj qe te investohet ne rruget e fshatrave sepse jane ne gjendje shumë të keqe.

Z.Frano Prenga – anëtarë i këshillit:Edhe une kam te njejtin shqetesim per n/stacionin ne Vau Dejes si dhe per parkingun ne qytet dhe gjithashtu kerkoj qe te mos parkohen makinat prane Bashkisë.

Këshilltarët nuk kishin diçka tjetër për të diskutuar.

Z.Ervis Shimaj – zv/kryetar i Këshillit Bashkiak Vau Dejës e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Mbylljet mbledhja e Këshillit Bashkiak për muajin Janar 2021.

Mbajtesi/Protokollit Sekretari Këshillit

Ardian CTELEPIA

Këshilltarët:

Franga Kola
zv. Kryetari: Ervis Shimaj

, Lelegjmer Ghermecop Jf.
, Kristjana Kovaci Jf.